



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	11.07.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP 03-03/2188/16
PËR/ZA/TO:	z. Haxhi BEJTA, Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Skenderajt
CC:	z. Fadil NURA, Nënkryetar i Komunës së Skenderajt
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Asfaltimi i rrugës në fshatin Likovc L=4760 m, ri-tenderim "

I nderuari z. BEJTA ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin "Asfaltimi i rrugës në fshatin Likovc L= 4760 m ri-tenderim" me numër prokurimi 643-16-013-521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin "**Asfaltimi i rrugës në fshatin Likovc L= 4760 m ri-tenderim**" me numër prokurimi 643-16-013-521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04/L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

A r s y e t i m i

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 01.07.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokolli *AKK-03-03-2188/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull *"Asfaltimi i rrugës në fshatin Likovc L=4760m ri-tenderim"* me numër *prokurimi: 643-16-013-521*, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Skenderajt.

Agjencia kundër Korrupsionit duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka trajtuar këtë procedurë të prokurimit dhe pas shqyrtimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim: Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë 20.06.2016, ku Autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë të llojit punë me vlerë të mesme të kontratës.

Pas analizimit të njoftimit për kontratë, Agjencia ka vërejtur se tek rubrika III.2.4. e kapacitetit teknik/profesional, pika 4 është kërkuar që Operatorët ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi (*kontrata ose referenca*) **se kanë përfunduar me së paku dy projekte në lëminë e kërkuar në tri vitet e fundit në vlerë prej 405,000.00 €, kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndesh me nenin 69 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik.**

Sipas këtij Ligji për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë vlera minimale referenca në lidhje me punët ndërtimore në 3 vitet e fundit përmes një liste që specifikon secilin nga projektet punuese të Operatorëve ekonomik dhe aktiviteteve të ndërtimit të kryera nga OE në 3 vitet e fundit të përcjellë me certifikatë të ekzekutimit të mirë që tregojnë vlerën, datën dhe llojin dhe vendin e projektit punues dhe/ose aktiviteteve të ndërtimit. Por nuk është e lejuar që të kufizohet numri i projekteve duke e caktuar edhe vlerën e projekteve të realizuara si në rastin konkret. Nëse Autoriteti kontraktues ka për synim që ta vërtetojë qarkullimin minimal financiar të realizuar përmes kontratave atëherë duhet që të kërkojë vlerën e përgjithshme monetare të punëve të realizuara në tri vitet e fundit e jo të kërkohet numri i kontratave me referenca në vlerat e caktuara si më lartë. Për me tepër kur përveç qarkullimit minimal, një qarkullim i caktuar minimal në fushat specifike të mbuluara me kontrata është i nevojshëm, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë 1.50 herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Gjatë analizimit të dosjes së këtij tenderi dhe krahasimit me njoftimin për kontratë e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit kontraktues, Agjencia ka vërejtur se këto dy dokumente nuk janë identike njëra me tjetrën më saktësisht në lidhje me pikën 9.1, e rubrikës kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale të dosjes së tenderit tek kërkesa c është kërkuar Lista e referencave të natyrës së njëjtë (ndërtimi i trotuareve ose rrugëve), ndërsa në njoftimin për kontratë Autoriteti ka kërkuar *kontrata ose referenca* nga Operatorët ekonomik **se kanë përfunduar me së paku dy projekte në lëminë e kërkuar në tri vitet e fundit në vlerë prej 405,000.00 €, veprim ky i cili bie ndesh me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik.** Duke vepruar në këtë mënyrë Autoriteti kontraktues krijon pa barazi dhe diskriminim në mesin e Operatorëve ekonomik.

Sipas nenit 13 paragrafi 2 i cili është plotësim i nenit 27 të Ligjit bazik nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-237, theksohet decidivisht se **Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike.**

Në pikën IV.3.5. të dosjes së tenderit është kërkuar sigurinë e tenderit me vlefshmëri prej 60 ditëve, ndërsa në pikën IV.3.6. tek pjesa e vlefshmërisë së tenderit Autoriteti kontraktues gjithashtu ka kërkuar vlefshmëri të tenderit prej 60 ditëve, veprim ky i cili bie ndesh me nenin 26 pika 6 e Udhëzuesit Operativ të Prokurimit publik. Sipas kësaj dispozite ligjore sigurimi i tenderit është opsional që nënkupton që në rast të kontratave me vlerë të madhe dhe të mesme, Autoriteti kontraktues mund të imponoj kërkesën e sigurimit të tenderit. Gjithashtu, sipas këtij neni “***Sigurimi i tenderit do të qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit***“. Në rastin konkret nëse Autoriteti kontraktues kërkon vlefshmëri të tenderit prej 60 ditëve, atëherë vlefshmërinë e sigurisë së tenderit duhet ta kërkojë në afat prej 90 ditëve.

Veprimet e Autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit, nenin 13 dhe nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale i Ligjit Nr. 05/L -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-237 dhe me nenin 26 pika e Udhëzuesit Operativ të Prokurimit publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet të lejohen dhe të përsëriten në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikatat e tilla në të ardhmen.

Me respekt !